



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 129 Datë 29.08.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN SHOQËRISË “AYEN AS
ENERGJI” SHA., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d” nenit 5 pika 1 gërma “d” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.08.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.79/7 prot, datë, 26.08.2019 nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sha në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sha., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/1prot., datë 22.08.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Shoqëria “Ayen AS Energji ” sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me nr.245, seria Fk14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.83, datë 16.09.2014, për një periudhë 5 vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 16.09.2019.
- Në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji” sha, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë pjesërisht.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”. Plotësuar pjesërisht.
 - Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, gërma “b”, “c”). Plotësuar.
 - Në lidhje me azhornimin e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
 - Nenin 9 pika 1 gërma “a”.
 - Nenin 9, pika 3 gërma “a” (Vërtetim për shlyerje tatim-taksash dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) do t’i kërkohet subjektit të sjellë vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave dhe nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore.
 - Nenin 9, pika 4, gërma “c”, (Lista e kontratatve të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike).
 - Nenin 9, pika 4, gërma “d”, (Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e kontratatve);
 - Nenin 9, pika 4.7, gërma “a”,. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti.
- do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sha., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR

Petrit AHMETI